



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9331/25 datë:28.04.2025



Npi – 01/165 datë: 02.05.2025

RREGULLORE

PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2025

- Me ndryshimet e bëra me vendimin e Kuvendit, Npi-01/23 të datës 27.01.2025
- Me ndryshimet e bëra me Rregulloren e Kuvendit, Npi – 01/165 datë: 02.05.2025

Shtime 2025

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (c) dhe 40.2 shkronja (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Udhëzimin Administrativ të (MSH) Nr. 03/2024 për bashkë pagesat për shërbimet shëndetësore; Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi – 01/118 datë:01.04.2025; Si dhe duke marrë për bazë Rekomandimin e MSH – Nr.05-1376 dt.25.02.2025 për Rishqyrtimin e Rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025. Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më datën: 02.05.2025, miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2025

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

QËLLIMI

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet lartësia e Taksave, Tarifave dhe Gjobave të parapara me këtë Rregullore, që janë aprovuar në Kuvendin e Komunës së Shtimes, që do t'i paguajnë personat Fizikë ose Juridikë në emër të shërbimeve të kryera, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës Komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve Komunale.

II LARTËSIA E TAKSAVE

Neni 2

Mbi bazën e Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës së Shtimes si dhe kësaj Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa, dhe Gjoba, personat fizikë ose juridikë në emër të shërbimeve të kryera Komunale do të paguajnë Tarifatat si vijon:

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHËSHME

Sektori i Përgjithshëm

Neni 3

3.1 Lëshimi i Certifikatave zyrtare:

Lloji i dokumentit	Shuma €
3.1.1 Certifikata e lindjes.....	1.00 €
3.1.2 Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile.....	1.00 €
3.1.3 Certifikata e vdekjes.....	1.00 €

3.1.4 Certifikatë e martesës.....	1.00 €
3.1.5 Certifikatë e gjendjes martesore.....	2.00 €
3.1.6 Vërtetim nga Arkivi	1.00 €
3.1.7 Procesverbal për pranimin e atësisë dhe amësisë.....	1.00 €
3.1.8 Certifikatë e Shtetësisë	1.00 €
3.1.9 Certifikatë e vendbanimit.....	1.00 €
3.1.10 Dëshmi e vdekjes.....	3.00 €
3.1.11 Vërtetime të ndryshme	1.00 €
3.1.12 Deklaratë e bashkësisë familjare	2.00 €
3.1.13 Regjistrimet e mëvonshme të lindjes, me certifikatë	5.00 €
3.1.14 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes – me certifikatë	1.00 €
3.1.15 Regjistrimi i martesës(ceremonia e martesës)	5.00 €
3.1.16 Regjistrimi i martesës (ceremonia e martesës jashtë objektit të Komunës).....	100.00 €
3.1.17 Kërkesa, Parashtresa, Ankesa	1.00 €
3.1.18 Vërtetim i mjeteve për jetesë për botën e jashtme	5.00 €
3.1.19 Kopje e dokumentit të vjetër nga Arkiva	1.00 €
3.1.20 Kërkesa për ndryshime ose përmirësime në librat AMË-s	5.00 €
3.1.21 Kërkesa për ndërrimin e emrit dhe mbiemrit	20.00 €
3.1.22 Ndërrimi i emrit dhe mbiemrit për fëmijët deri në 10 vjetë, paguhet	5.00 €
3.1.23 Për rikthimin e mbiemrit të vajzërisë paguhet taksa prej	3.00 €
3.1.24 Dokumentet e lëshuara nga E-Kiosku.....	1.00 €

3.2 Lëshimi i Certifikatave zyrtare përmes ëeb-faqes-postes elektronike-online:

Lloji i dokumentit	Shuma €
3.2.1 Certifikata e lindjes	2€
3.2.2 Certifikata e vendëbanimit.....	2€
3.2.3 Certifikata e Martesës.....	2€
3.2.4 Certifikata e Shtetësisë.....	2€
3.2.5 Ekstrakti i lindjes	2€

3.3 Bazuar në nenin 63 të Ligjit për Gjendjen Civile, Nr.04/L-003, Me gjobë denohet personi që bën këto shkelje:

3.3.1 ku thuhet: Me gjobë në vlerë prej 20.00 euro (minimumi) dënohet personi që nuk paraqet lindjen e fëmijes në afatin e paraparë me ligj.

3.3.2 ku thuhet: Me gjobë në vlerë prej 50.00 euro (minimumi) dënohet personi që nuk e lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas ligjit.

3.4 Sipas nenit 3.1 Nga të gjitha pagesat lirohen këta persona: Personat në asistencë sociale, Invalidët e luftës, Familjet e dëshmorëve, Veteranët e luftës (Familja e ngushtë), Ish të burgosurit politik(vetëm individ), Invalidët civil të luftës (vetëm individ). Personat me aftësi të kufizuar (me anëtarët e ngushtë të familjes).

3.5 Gjithashtu lirohen nga të gjitha pagesat sipas nenit 3.1 edhe rastet që janë në fazën e aplikimit për asistencë sociale e të cilën gjë mund ta dëshmojnë me dokumentin nga Qendra për Punë Sociale se janë në fazë të aplikimit.

3.6 Parashtruesit e kërkesës sipas nenit 3.3 duhet të dëshmojnë se i takojnë njërës nga kategoritë e caktuara si dhe afërsinë familjare me parashtruesin e kërkesës.

3.7 Lirohen nga pagesa e taksës administrative parashtuesit e kërkesës për interes të përgjithshëm për lëshimin e dokumentit nën pikën 3.1.17 dhe 3.1.19 të cilën e bëjnë zyrtarët nga institucionet shtetërore/për nevoja zyrtare shtetërore, Institucioneve Publike, Kryetarët e Fshatrave, Bashkësive lokale, Përfaqësuesit e Shkollave, OJQ-ve, dhe Shoqatave Humanitare.

3.8 Nga pagesa e taksës Administrative lirohen pjestarët e komunitetit RAE në bazë të Memorandumit në mes të KK-Shtime dhe CRP/K (Programi për të Drejtat Civile në Kosovë). Përkatesia etnike e këtyre komuniteteve vërtetohet nga ana e Zyrës për Komunitete (Formulari).

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, KADASTËR DHE GJEODEZI

1. Sektori për Urbanizim dhe Ndërtim

Neni 4

4.1 Duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit Nr.04/L-110, Udhëzim Administrativ MMPH- Nr.02/18 për Taksat Administrative, për Leje Ndërtimore, Leje Rrënimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përcakton këto tarifa ndërtimore për Sektorin e Urbanizmit dhe Ndërtimit:

4.2 Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore -Kategoria I- për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përllogaritur për vitin 2025 është: 1.30€ /m². (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m² x m² e ndërtimit= taksa e ndërtimit)

4.3 Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore -Kategoria II- për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përllogaritur për vitin 2025 është: 2.00€ /m². (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m² x m² e ndërtimit= taksa e ndërtimit)

4.4 Tarifa për rritjen e Densitetit të Infrastrukturës për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përllogaritur për vitin 2025 është: 154.50€. Kjo taksë aplikohet vetëm për njësitë e reja të banimit. (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit)

Formula:

$$\left(\frac{\text{njësia e re banuese}}{\text{(m}^2\text{)}} \div \frac{\text{nr.banorve per njësi}}{\text{(50)}} \right) \times \text{Tarifa rregullati ve për rritjen e densitetit të infrastrukturës për kokë banori}$$

4.5 Taksa Administrative për Leje Rrënimi për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përllogaritur për vitin 2025 është: 0.70€ /m². (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m² x m² e ndërtimit= taksa e rrënitimit)

4.6 Taksa Komunale për ndërtim të infrastrukturës, përcaktohet në bazë të nenit 17.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, dhe duhet të përcaktohet në bazë të Marrëveshjes për Infrastrukturë në mes aplikantit dhe organit kompetent të përshkruar në ligjin e Ndërtimit Nr.04/L110, neni 23, neni 7,8 dhe 9 i Udhëzimit Administrativ MMPH- Nr.02/18 Për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, për Leje Rrërimi si dhe Tarifatat për Rregullimin e Infrastrukturës. Kontrata duhet të jetë ligjërish e zbatueshme që specifikon termat dhe kushtet për sa i përket financimit dhe sigurimit të infrastrukturës.

4.7 Nga nenet e taksave 4.2 dhe 4.3 lirohen ndërtimet e karakterit Bujqësor, Subjektet Afariste në Zonat Ekonomike në Shtime, si dhe të gjitha subjektet afariste që kanë në shfrytëzim pronat e pa luajtshme komunale në bazë të vendimeve për dhënie në shfrytëzim pronën e pa luajtshme komunale.

4.8 Referenca për projektet e realizuara në Komunën e Shtimes10.00 €

4.9. Ndërtimi i objekteve të infrastrukturës:

4.9.1 Për aktin me të cilën lejohej grupimi për ndërtimin e infrastrukturës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.9.2 Rrjet ujësjellësi (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.9.3 Rrjet kanalizimi (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.9.4 Rrjet elektrike të tensionit të ulët (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.10 Për aktin me të cilën lejohej grupimi për ndërtimin e trasave kablovike dhe ajrore të infrastrukturës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.10.1 Rrjet telekomunikacioni dhe televizive (Për metër Gjatësi).....0.40 €

4.10.2 Rrjet elektrike të tensionit të lartë (Për metër Gjatësi) 0.50 €

4.11 Për aktin me të cilën lejohej ndërtimi i objekteve të infrastrukturës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.11.1 Antena (GSM) – (Për Copë).....150.00 €

4.11.2 Antena – internet e të ngjajshme – (Për Copë)100.00 €

4.11.3 Trafostacionet shtyllë – (Për Copë).....50.00 €

4.11.4 Trafostacionet Blindë – (Për Copë).....100.00 €

Neni 5

Tarifat për shërbimet Online

5.1 Për një përdorues GUI për person tarifa është.....20 €

5.2 Për një përdorues UCËSS si institucion100 €

5.3 Mirëmbajtja vjetore për shërbimet e ofruara online është.....200 €

5.4 Përfshirja nga paragrafi 16.3 i këtij neni, bëhet për personat fizik dhe juridik të cilët regjistrojnë të drejtën e hipotekës;

5.5 Bazuar në paragrafin 16.4 të këtij, regjistrimi i hipotekës është 5 euro, ndërsa modifikimi dhe fshirja e saj është pa pagesë.

5.6 Verifikimi i informacioneve për njësi kadastrale është2 €

5.7 Verifikimi i informacioneve për person është6 €

5.8 Tarifatat e përcaktuara në paragrafin 16.6 dhe 16.7 të këtij neni, vlejnë për të gjitha institucionet publike dhe ato private që me ligj kanë autorizime publike.

- 5.9 Nxjerrja e certifikatave online është3 €
- 5.10 Lirohet nga tarifa për regjistrimin e shënimit nga përdoruesit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Përdoruesi nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që të bëjë rexhistrimin e shënimit.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Neni 6

6.1 Pëlqimi Komunal për aktivitete biznesi:

- 6.1.1 Lëshimi i Lejes për punë me auto-taxi30.00 €
- 6.1.2 Vazhdimi i lejeve për auto-taxi10.00 €
- 6.1.3 Ndarja e vijave të reje të autobusit urban dhe periferik50.00 €
- 6.1.4 Vazhdimi i linjave të autobusit në trafikun urban dhe periferik.....30.00 €
- 6.1.5 Regjistrimi për punë me Kioska15.00 €

6.2 Për Leje Mjedisore Komunale zbatohen procedurat në bazë të Ligjit Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe neni 15 pika 1.1 dhe 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 datë 02.05.2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.

6.2.1 Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj tarifën prej 0.2% të vlerës investuese mbi 25,000.00 €.

6.2.2 Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj 50.00 € për vlerë investive deri 25,000.00 €

6.2.3 Paragrafi 6, Nenparagrafet 6.2.1 dhe 6.2.2 lirohen nga të gjitha taksat komunale Institucionet Publike dhe donatorët.

6.3 Gurëthyesit dhe eksploatuesit e gurit-zhavorit do të paguajnë si vijon:

- 6.3.1 0-5000m³ 2,000.00 €
- 6.3.2 5100 deri 10000m³3,000.00 €
- 6.3.3 11000 deri 20000 m³ 5,000.00 €
- 6.3.4 21000 deri 50000 m³ 10,000.00 €
- 6.3.5 51000 deri 70000 m³ 15,000.00 €
- 6.3.6 Mbi 71000 m³ 20,000.00 €

6.4 Betonjerkat3,000.00 €

6.5 Lejet për qarkullimin e automjeteve të rënda motorike në rrugët ku është ndaluar qarkullimi i automjeteve në fjalë, për ngarkim – shkarkim të mallit mbi 7 tonë:

- 6.5.1 Leje në rrugët ‘T. Sinani’ ‘Komandant Kumanova’ dhe ‘A. Jashari’ 1 deri 3 ditë...10.00 €
- 6.5.2 Leje për të gjitha rrugët tjera - 1 deri 3 ditë5.00 €
- 6.5.3 Leje - 1 deri 15 ditë15.00 €
- 6.5.4 Leje mujore për 1 Kamion.....25.00 €
- 6.5.5 Leje vjetore për 1 Kamion150.00 €
- 6.5.6 Leje vjetore për çdo Kamion të dytë ose më shumë i shtohen edhe nga50.00 €
- 6.5.7 Të gjithë operatorët që nuk janë të komunës së Shtimes e të cilët furnizohen apo furnizojnë bizneset në komunën e Shtimes duhet të deshmojnë me faturë furnizimin apo shitjen e mallrave nëpër këto biznese që kanë leje qarkullimi mbi 7 tonë, e cila lëshohet për të gjitha veprimtarit e bizneseve në komunën e Shtimes vetëm nëpër rrugët të cilat janë të lejuara me rregullore komunale.

Neni 7

7.1 Taksa për pronësinë në automjet:

7.1.1 Të gjithë pronarët – poseduesit e automjeteve motorike në Komunën e Shtimes të cilat rexhistrohen duhet të paguajnë taksën Komunale sipas kësaj tablele:

Nr.	Emërtimi – Lloji i Automjeteve	Shuma €
1.	-Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme deri në 3500 kg. -Të gjitha llojet e Motoçikletave që rexhistrohen.	10.00
2.	- Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme mbi 3500 kg. - Të gjithë Autobusët dhe Minibusët.	20.00
3.	- Lirohen nga pagesa të gjitha llojet e Rimorkios, Traktorët dhe mjetet tjera bujqësore.	00.00

7.2 Nga Taksa për pronësinë në automjet lirohen:

7.2.1 Automjetet e: Emergjencës, Zjarrëfiksive, Policisë, Komunës, Shoqatave jo qeveritare, Ushtarake, dhe të organizmave ndërkombëtarë - Dëshmi për këtë është Libreza e Automjetit.

7.2.2 Familja e ngushtë e Dëshmorëve të UÇK-së, dhe Invalidët e luftës së UÇK-së;

7.2.3 Personat me Invaliditet ushtarak dhe të punës, dëshmi për këtë është: Vendimi mbi Invaliditetin nga Ministria e Punës.

7.2.4 Personat me aftësi të kufizuara, dhe Ish të burgosurit politik.

7.2.5 Veteranët e UÇK-së

7.2.6 Lirimi nga taksat sipas kësaj Rregulloreje, bëhet pasi që pala të prezantoj dëshmi për statusin përkatës.

7.3 Taksa Komunale për shfrytëzimin e Pronës Komunale me destinacion të përkohshëm:

7.3.1 Kiosqet (Qoshqet), Objektet Montazh etj. në Komunën e Shtimes janë të obliguar të paguajnë taksën për një Muaj sipas kësaj tablele:

Nr.	Zonat	Sasia	Çmimi për 1 Muaj
1	Zona e parë – Urbane	1 m ²	2 €
2	Zona e dytë - Rurale	1 m ²	1 €

7.4 Taksat për shfrytëzimin e hapsirave të tregut sipas llojeve paguhen sipas kësaj tablele:

Nr	Tregu	Përshkrimi	Ditët	Njësia matëse	Çmimi për Një Ditë €	Çmimi për Një Vit (Rezervim)
1.	I Plaçkave dhe i gjelbërt	Tezgë – Lokacion për shitje të Mallit	E premtë	1 m ²	1.00	(2 m ²) 100.00 €
2.	I Plaçkave dhe i gjelbër	Tezgë – Lokacion për shitje të Mallit	Për ç'do ditë	1 m ²	0.50	(2 m ²) 150.00 €
3	Hapsira Publike	Shfrytëzimi i Lokacionit (polygon) për Autoshkolla	Në Treg, përveç ditës e Premtë	Paushall	/	Çmimi për një Muaj 30€
4.	I Kafshëve	Shitja e Kafshëve të trasha	E premtë	1 Copë	2.00	/
5.	I Kafshëve	Shitja e Kafshëve të imëta	E premtë	1 Copë	0.50	/

6.	I Gjellbër dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkio, etj.	E premtë	1m. gjatësi	1.00	/
7.	I Gjellbër dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkio, etj.	Për ç'do ditë	1m. gjatësi	0.50	Deri 3500 kg - 100.00€ Mbi 3500 kg - 150.00€
8.	I Plaçkave dhe i gjellbër	Parkimi i automjeteve	Përveç e Premte e Shtun e Dielë	1 Copë	0.50	/
9.	I Kafshëve	Peshorja e kafshëve	Për një vit	Paushall	/	150.00€
VËREJTJE: Zhavorri ose materiali tjetër ndërtimor nuk është i lejuar të zbrazet në tokë, në lokacionin e tregut.						

7.5 Taksat për shfrytëzimin e hapësirave publike në Komunën e Shtimes, paguhën sipas kësaj tablele:

MBI BAZËN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE, DHE LEJES TË LËSHUAR NGA ORGANI KOMPETENT I ADMINISTRATËS KOMUNALE PAGESA KRYHET NË VALUTËN EURO PËR NJË METËR KATROR SIPËRFAQE KOMUNALE-PUBLIKE QË SHFRYTËZOHET - SIPAS KËSAJ TABELLE:					
PAGESA SIPAS ZONAVE -€					SHFRYTËZIMI I PËRKOHSHËM I HAPSIRAVE KOMUNALE-PUBLIKE:
Për Muaj	Zona I	Zona II	Zona III	Zona Rurale	
1	5	4	3	2	1. Shitje sezonale të Lëvizshme, (Frigorifer, Fara, Cigare etj) 2. Vendosje të Panairëve, Tregje dhe Reklamim të automjeteve, 3. Shfrytëzimi i sipërfaqes për Reklam. të mallrave të ndryshëm 4. Vendosja e Reklamave, pagesa për metër katror të reklamës, 5. Vendosja e Verandave, Pushimoreve, Çadrave për biznese etj, 6. Vendosje të pajisjeve për lojëra të ndryshme dhe argëtim, 7. Vendosje të përkohshme të pajisjeve dhe materialit për ndërtim, 8. Vendosje të Kontejnerëve për mbeturina ricikluese për m³. 9. Shfrytëzimi i sipërfaqes- hapësirës publike për nevoja të ndryshme të qytetarëve. 10. Pagesa për parkimin e automjetit, dhe me rimorkio në Parkingun Publik në Rrugën kryesore - Shtime është 0.20€ (Njëzet cent) për një orë.
2	8	6.40	4.80	3.20	
3	12	9.60	7.20	4.80	
4	16	12.80	9.60	6.40	
5	20	16	12	8	
6	24	19.20	14.40	9.60	
7	28	22.40	16.80	11.20	
8	32	25.60	19.20	12.80	
9	36	28.80	21.60	14.40	
10	40	32	24	16	
11	44	35.20	26.40	17.60	
12	48	38.40	28.80	19.20	

7.6 Për dhënien e Objekteve të mëdha ose sipërfaqeve të tokës, Komunale-Publike me qira ose në forma tjera për shfrytëzim afatshkurtë ose afatgjatë, kërkesa e palës duhet të i nënshtrohet procedurës administrative, sipas Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës dhe Rregulloreve të Komunës së Shtimes, dhe për të vendos Kuvendi i Komunës ose Organet e tij.

7.7 Tarifat fikse (Pa-TVSH) për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave Mikse (të përziera) në Komunën e Shtimes.

Amvisëritë

7.7.1 Amvisëritë paguajnë tarifën mujore në shumën prej5.99 €

Komerciale/Industriale

7.7.2 Kategoria -I- Përfshihen, Dyqanet e vogla dhe artizanale të cilat paguajnë shumën mujore prej.....9.59 €

7.7.3 Kategoria -II- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të ulët të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....13.54 €

7.7.4 Kategoria -III- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të moderuar të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....23.60 €

7.7.5 Kategoria -IV- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të lartë të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....31.16 €

Bizneset me kontrata të Veqanta

7.7.6 Kategoria -V- Për Kontejnerët 1.1 m³ ,paguajnë për ç'do zbraze shumë.....15.58 €

7.7.7 Kategoria -V- Për Kontejnerët 5.1 m³ ,paguajnë për ç'do zbraze shumë.....66.11 €

Institucionet me kontrata të Veqanta

7.7.8 Kategoria -V- Për Kontejnerët 1.1 m³ ,paguajnë për ç'do zbraze shumë.....15.58 €

7.7.9 Kategoria -V- Për Kontejnerët 5.1 m³ ,paguajnë për ç'do zbraze shumë.....66.11 €

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 8

8.1 Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në jobujqësore

8.1.1 Me këtë bëhet caktimi ndryshimit të destinimit të sipërfaqeve bujqësore sipas Udhëzimit Administrativ, Nr.41/2006, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

8.1.2 Në komunën e Shtimes sipas strukturës së sipërfaqeve bujqësore ekzistojnë tetë klasë.

8.1.3 Kompensimi për ndryshim të destinimit të Tokës sipas klasave bëhet sipas tabelës në vijim:

Klasa I-rë deri IV-të	Kompensimi	1.00 €/m ²
Klasa V-të dhe VI-të	Kompensimi	0.75 €/m ²
Klasa VII-të dhe VIII-të	Kompensimi	0.50 €/m ²

8.1.4 Përcaktimi i këtyre kuotave financiare sipas kategorive dhe klasave është rezident vetëm për zonën urbane të ndarë në tri zona.

8.1.5 Përjashtime nga neni 8.1.4 mund të bëhen vetëm për rastet kur ndërrimi i destinimit të tokës ka të bëjë me ndërtimin e Objekteve bujqësore, Fermave, Fidanishteve, Serrave dhe objekteve me karakter zhvillimi të bujqësisë.

8.1.6 Vërtetim për marrje me veprimtari bujqësore, kompensimi për persona fizikë2.00 €

8.2 Shërbimet profesionale për prerjen e pyjeve private:

8.2.1 Dru zjarri për m³ në shumë prej1.50 €

8.2.2 Dru zjarri për 7m³ në shumë prej2.00 €

8.2.3 Dru teknik për 7m³ në shumë prej3.00 €

8.3 Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullosave

Nr	Lloji i Bagëtisë	NB / për kokë	Euro / për kokë
1	Gjedhët mbi një vit	1	1.20
2	Viçat	0.45	0.54
3	Delet	0.18	0.22
4	Çengjat	0.10	0.12
5	Kuajtë – Gomarët	1	1.20
6	Dosat	0.50	0.60
7	Derrat	0.30	0.36
8	Rosat	0.014	0.02

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Neni 9

9.1 Çertifikata që ka të bëjë me vlerësimin e pronës dhe kapitalit:

9.1.1 Pagesa në rastin kur lëshohet nga zyra mbi provat (dokumentacionit)5.00 €

9.1.2 Pagesa në rastin kur duhet bërë vlerësimin përmes komisionit profesional në teren dhe kur duhet sajuar procesverbalin përkatës	25.00 €
9.1.3 Vërtetime të ndryshme	1.00 €

9.2 Pëlqimi Higjeniko-teknik:

9.2.1 Objektet industriale.....	10.00 €
9.2.2 Shitja e derivateve të naftës (pompat e benzinës), depot e gazrave.....	25.00 €
9.2.3 Restorantet, hotelet, motelet, therrtoret, objektet për prodhimin e ushqimit	25.00 €
9.2.4 Ordinancat shendetsore private, barnatoret mjeksore, barnatoret bujqesore dhe laboratorët biokimike.....	25.00 €
9.2.5 Vetshërbimet Sh.p.k.....	15.00 €
9.2.6 Kuzhinat (gjelltorët)	15.00 €
9.2.7 Ëmbëltoreset, Kafiterit.....	15.00 €
9.2.8 Dyqanet tregëtare të pavarura	10.00 €
9.2.9 Dyqanet e pavarura zejtare-tregëtare.....	10.00 €
9.2.10 Dyqanet e pavarura zejtare-shërbyese.....	10.00 €
9.2.11 Zyret dhe agjensitë	10.00 €
9.2.12 Kiosqet.....	5.00 €
9.2.13 Veprimtarit Shërbyese në sektorin e Teknologjis Informative dhe produkteve të tyre dhe të gjitha veprimtarit e kësaj lamiye.....	25.00 €

9.2.14 Mos paisja me pëlqime sanitare, mjedisore dhe aktet tjera zyrtare do të zbatohen dispozitat ndeshkuese me ligjet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.

9.2.15 Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetent Inspektorati Komunal dhe Policia e Kosovës.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Neni 10

10.1 Tarifat Komunale për dokumentat që lëshon DSHMS-ë dhe QPS-ë:

10.1.1 Vërtetim për Dëshmorët.....	(lirohen)
10.1.2 Formulari për trajtim jashtë vendit.....	(lirohen)
10.1.3 Vërtetimi për skemën invalidore dhe të plagosurit e luftës.....	(lirohen)
10.1.4 Vërtetim nga participimi.....	(lirohen)
10.1.5 Vërtetim i gjendjes Sociale.....	1.00 €
10.1.6 Vërtetimet tjera	1.00 €
10.1.7 Vërtetim që nuk i është marrë e drejta për të vepruar apo e drejta prindore	2.00 €
10.1.8 Vërtetim që familja nuk merr asistencë sociale (për shtetet e jashtëme)	2.00 €
10.1.9 Vërtetim (mendimi) për martesë të parakohshme	3.00 €
10.1.10 Vërtetim për rexhistrim të më vonshëm të fëmijëve	2.00 €
10.1.11 Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijë	2.00 €
10.1.12 Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimit	2.00 €
10.1.13 Pëlqim për bartjen e pasurisë	2.00 €
10.1.14 Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijët e moshës jo madhore	2.00 €
10.1.15 Kërkesë për përfaqësim në Gjykata për fëmijët lidhur me trashëgimi.....	3.00 €
10.1.16 Konstatime të ndryshme zyrtare	3.00 €
10.1.17 Pranim i Atësisë dhe Amësisë	3.00 €

10.2 Duke u bazuar në U.A. Nr.03/2024 të datës 05.11.2024, dhe U.A.Nr. 04/2013 të datës 10.04.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesa e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të instucioneve shëndetsore, çmimorja e pagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor është:

10.2.1 Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00 €
10.2.2 Egzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes.....	2.00 €
10.2.3 Egzaminimi specialistik në QMF/QKMFpa udhëzim të Mjekut të Familjes.....	5.00 €
10.2.4 Egzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00 €
10.2.5 Ultrazëri Standard	2.00 €
10.2.6 Radiografia	2.00 €
10.2.7 EKG	0.50 €
10.2.8 Analizat Laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina	1.00 €
10.2.9 Analizat laboratorike (komplet)	3.00 €
10.2.10 Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkeses së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.....	1.00 €
10.2.11 Audiogrami	1.00 €
10.2.12 Shpërlarja e veshit	1.00 €
10.2.13 Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në viziten e parë)	1.00 €
10.2.14 Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00 €
10.2.15 Çertifikata shëndetësore për edukim dhe shkollim (Lirohen nga pagesa në sektorin publik, bazuar në Ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj).....	10 €
10.2.16 Çertifikata shëndetësore për punësim.....	15 €
10.2.17 Dhënja e raportit mjekësor, vertetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetsore	5.00 €
10.2.18 Ofrimi i shërbimeve shëndetsore gjatë aktiviteteve sportive, etj. - për një orë	25.00 €
10.2.19 Vizitë e parë stomatologjike	1.00 €
10.2.20 RTG i dhëmbit	1.00 €
10.2.21 Mbushje e përhershme me amalgam	3.00 €
10.2.22 Mbushje e përhershme me kompozitë	4.00 €
10.2.23 Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	4.00 €
10.2.24 Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	5.00 €
10.2.25 Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	5.00 €
10.2.26 Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	5.00 €
10.2.27 Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	5.00 €
10.2.28 Terapia e kanalit të infektuar të përhershme (amalgam apo kompozitë).....	5.00 €
10.2.29 Rindërtimi konzervativ i dhëmbit me bushje të përhershme.....	5.00 €
10.2.30 Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjes.....	1.00 €
10.2.31 Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave.....	1.00 €
10.2.32 Vulosja e fisurave.....	1.00 €
10.2.33 Mënjanimi i depozitimeve të buta.....	1.00 €
10.2.34 Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzëve të dhëmbëve me ultratingull).....	3.00 €
10.2.35 Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmb).....	1.00 €
10.2.36 Nxjerrja e dhëmbit.....	1.00 €
10.2.37 Incizioni intra dhe extra oral.....	1.00 €

10.2.38 Heqja e kurorës me anë të prerjes.....	1.00 €
10.2.39 Riparimi i protezës (ngjitja).....	1.00 €

DREJTORIA PËR ARSIM

Neni 11

11.1 Duke u bazuar në U.A. të MASHT-it Nr.11/2011 të datës 30.12.2011 për Participimin e vijuesve të Arsimit dhe Aftësimin për të Rritur. pagesa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur është:

11.1.1 Për regjistrimin e vitit.....	100.00 €
11.1.2 Për praktikë profesionale	50.00 €
11.1.3 Provimi diferencial.....	10.00 €
11.1.4 Për provimet përfundimtare të klasës, Certifikatën.....	30.00 €
11.1.5 Për diplomë të përfundimit të shkollimit	20.00 €

11.2 Duke u bazuar në U.A. Nr.03/2013 të datës 21.01.2013 të MASHT-it, dokumentacioni publikatë lëshohet nga institucionet e arsimit përkatës në këto raste:

11.2.1 Nëse është i humbur.....	1.00 €
11.2.2 Nëse është djegë.....	1.00 €
11.2.3 Nëse është dëmtuar.....	1.00 €
11.2.4 Nëse është asgjësuar.....	1.00 €
11.2.5 Nëse është i plotësuar me gabime.....	1.00 €

11.3 Duke u bazuar në vendimin Npi-01/238, datë 15.09.2011 të Kuvendit Komunal të Shtimës për caktimin e tarifës participuese të fëmijëve në çerdhe kemi:

11.3.1 Pagesa për qëndrim ditor të fëmijëve në Institucion Parashkallor.....	35€/muaji
11.3.2 Gjatë periudhës së pushimeve verore, përgjysmë muaji tarifa e pagesës është.....	17.50 €.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 12

12.1 Lartësia e ngarkesave që do të paguajnë personat fizikë ose juridikë në emër të shërbimeve apo të veprimtarive Kulturore Komunale do të jen si vijon:

Për Bibliotekë pagesat vjetore të anëtarimit janë:

12.1.1 Sektori për të rritur mbi moshën 18 vjeq.....	2.00 €/vit
12.1.2 Sektori për fëmijë nën moshën 18 vjeq.....	1.00 €/vit

Për Aktivitetet në Shtëpinë e Kulturës pagesat janë:

12.1.3 Bileta për përcjelljen e shfaqjeve teatrore	1.00 €
12.1.4 Bileta për përcjelljen e shfaqjeve për fëmijë.....	1.00 €
12.1.5 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete tjera (për shfrytëzuesit jo banor të Komunës së Shtimes)	50.00 €/orë

12.1.6 Lirohen nga pagesa për pjesëmarrje në aktivitetet kulturore këto kategori: fëmijet e dëshmorëve, fëmijet e invalidëve të luftës, fëmijet e veteranëve, pensionistet, rastet sociale, personat me aftësi të kufizuara dhe vullnetarët që posedojnë dëshmi sipas kategorisë së përcaktuar.

12.2 Pagesat për shfrytëzimin e objekteve dhe fushave sportive:

12.2.1 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete sportive, rekreative për 1 orë..... 50.00 €/orë

12.2.2 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete jospportive për 1 orë 50.00 €/orë

Për aktivitetet në Stadionin e qytetit pagesat bëhen:

12.2.3 Shfrytëzimi i Stadionit për aktivitete sportive, rekreative për 1 orë50.00 €/orë

12.2.4 Lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e objekteve sportive këto kategori: të gjitha klube sportive lokale të licencuara nga DKRS, të gjitha institucionet komunale të arsimit.

III DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 13

”Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë për personat fizik, ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi për kundërvajtjet, respektivisht nenit 29 (paragrafit 4 dhe 5) të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtjet”.

IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2024, me numër Npi-01/74 datës: 26.02.2024.

Neni 15

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisjen Lokale, dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

Neni 16

Implementimin e kësaj rregullore janë të obliguar ta bëjnë: Kryetari, të gjitha Drejtoritë Komunale si dhe të gjitha Institucionet në nivelin e lokal të Komunës së Shtimes.

Neni 17

Rregullorja dhe Vendimi u dërgohen: Arkivit, Drejtorive, Institucioneve lokale, Kryetarit të Komunës, MAPL, MEF dhe Zyrës për Informim.



KRYESUESI I KUVENDIT

Adnan Ademi
[Signature] 21